Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/425
Datë: 16.11.2016

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 9, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa për lejim për aplikim për validim dhe akreditim të institucionit për ato kualifikime për të cilat ekzistojnë standardet e profesionit të miratuara në nivel kombëtar.

2. Kolegjit "Fama" i lejohet që të aplikojë për validim dhe akreditim të institucionit për këto kualifikime:
   - Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit;
   - Instalues i ngrohjes qendrore;
   - Instalues elektrik;
   - Teknik Agrobiznesi;
   - Shitës;
   - Automekanik/e;
   - Parukier/e;
   - Pedikyrist/e;
   - Saldues;
   - Metalpunuës.

3. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i obliguar që të njoftojë institucionin për përgatitjen e aplikimit dhe të vazhdojë procesin sipas legjislacionit në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet të gjitha palëve të interesit.



Nën-kryetari i KD së AKK
Anton Gojani